



Pranuar / Dërguar Prilbjen / Pristato Received / Delivery	06.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SLMESHUK	2396/2023		1/7



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.95/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.95/2023 të datës 19.01.2023 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_, nga Prishtina, kundër Vendimit me Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-transferim për shkak të riskstrukturimit", duke vepruar sipas nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 03.03.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.95/2023 e datës 19.01.2023, e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.150/2023 i datës 11.01.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

**A r s y e t i m**

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 19.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 510/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljes së ligjit material, shkelje thelbësore të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli më datë 07.02.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me dokumentet lidhur me këtë çështje.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative,** ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 510/2023 të datës 19.01.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër protokolli 1610 të datës 10.09.2019; Vendimin me numër 228-1/2005 të datës 29.05.2005 të Odës së Avokatëve të Kosovës; Kontratën e punës së ankuseses së datës 16.07.2007; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme e datës 06.11.2007; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me Nr.prot:332/2010 e datës 30.04.2010; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nr.prot:631/2008 e datës 01.03.2008; Vendimin me Nr. 756/2008 e datës 30.04.2008; Kontratën e Marrëdhënies së Punës me Nr.755/2008 e datës 30.04.2008; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshëm me Nr.prot:183/2007 të datës 20.12.2007; Certifikatën e marrëdhënies së punës me Nr.prot:672/2011 e datës 09.08.2011; Akt Emërimit e datës 05.04.2012; Vendimin mbi avancim e datës 05.05.2012; Kontratë e Marrëdhënies së Punës me Nr.Ref:094/2012 të datës 02.02.2012; Vendimin me Nr.Ref: 076/2012 të datës 25.01.2012; Akt Emërimit me Nr.Ref: 293/2014 të datës 21.03.2014; Vendimi me Nr.902/2013 të datës 20.09.2013; Vendimin me numër protokolli 652 të datës 02.05.2019; Vendimin me numër protokolli 1723 të datës 22.11.2018; Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.12/2022 të datës 10.05.2022 të DMZP-së; Vendimin me Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 13.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 939/2023 të datës 26.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1506 të datës 07.02.2023; Vendimin me Nr.114/2022 të datës 28.07.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin për zgjatjen e afatit të punës së Komisionit të Ristrukturimit me Nr. Ref: 46/2022 të datës 23.03.2022; Raportin e veçantë të punës së Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë me numër protokolli 1620 i datës 01.11.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Drejtor i Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë i datës 14.08.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Autoritetit Rajonale të Pellgjeve Lumore i datës 23.05.2019; Njoftim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore-MPJD e datës 27.10.2022, dhe 28.10.2022, Vendimin V.nr.01/KR/2022 i datës 24.02.2022 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit; Sqarim i datës 11.03.2022 përmes emalit; Njoftimin me numër protokolli 843 i datës 15.03.2022 për ankuesen nga Udhëheqësi i Divizionit për Burimeve Njerëzore në MPJD; Vendimin VPD.Nr.01/2022 i datës 16.03.2022 për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në MPJD; Certifikatën e trajnimit e vitit 2007; Certifikatë trajnimi maj 2016; Certifikatë trajnimi shkurt 2015; Certifikatë tetor 2014; Certifikatë trajnimi shtator 2014;



Certifikatën trajnimi për periudhën 10-25.06.2013; Certifikatën trajnimi maj 2013; Certifikatën trajnimi për periudhën 10-30.04.2013; Certifikatën trajnimi për periudhën 23-24.04.2012; Certifikatën trajnimi për periudhën 28-29.03.2012; Certifikatën nga Foreign language e datës 07.09.2005, 26.11.2005, 18.05.2005, 22.12.2005; Certifikatën e datës 15.04.2007; Letër motivues dhe CV e ankueses; Mirënjohje qershor 2019; Diplomën me Nr. 1125 e datës 14.07.2005 për ankuesen; Certifikatën e datës 29.03.2005; Diplomën me Nr.1197 e datës 15.09.2016; Akt Emërimin e datës 04.11.2021 për S.U; Aktvendim për S.U; Certifikatën e datës 25.10.2010 për S.U; Certifikatën e marrëdhënies së punës me Nr. prot:1189/2008 e datës 18.07.2008; CV-në e S.U; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.ref MPJ-ZDP-005/8; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr. 265 të datës 15.05.2008; Kontratën mbi Vepër e datës 11.04.2014 dhe 06.02.2016; Marrëveshjen për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil e datës 21.01.2011; Notë Verbale me numër Ref: No DP 149/16; Rekomandimin ZDP/88/2020 i datës 23.06.2020; Rekomandimin me Nr. Ref: 125/C/2020 të datës 15.12.2020; Shkresë Emërimi e datës 14.01.2003; Formulari për vlerësimin e përmbushjes së detyrave të punëtorëve në Zyrën e Kryeministrit i datës 12.12.2002; Shkresë Emërimi e datës 15.04.2003; Vendimi për lëvizje paralele me Nr.133/2008 i datës 09.07.2008; Vendimin me Nr. Ref:272/2014 i datës 30.04.2014; Vendimin me numër 130/2019 të datës 01.11.2019; Vendimin me Nr.prot:1162/2008 i datës 16.07.2008; Vërteti me numër protokolli 05/99/13 i datës 21.03.2013; Vërtetimin me Nr.prot:3/730 i datës 08.12.2017; Vërtetimin me numër protokolli 3193/2013 i datës 16.07.2013; Akt Emërimin AE.Nr.111/2022 i datës 13.06.2022; Diplomën me Nr. 2165 e datës 09.06.2021; Diplomën me Nr.82 të datës 21.01.2011; Vendimin me numër Ref: Nr.216-317 të datës 30.12.2021; Certifikatën doktorate e datës 16.10.2017; Diplomë me Nr.89 të datës 01.07.2002; Shtojca II/formulari i vlerësimit për Drejtor të Departamentit për Diasporë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç'rast si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve për pozita të caktuara. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar Komisioni i Ristrukturimit), kurse, me Vendimin me shenjën VPD Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 ka miratuar përshkrimin e detyrave të punës të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me tej nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 1610 të datës 10.09.2019 ka qenë e emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë në ish Ministrinë e Diasporës, ndërsa sipas Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë. Ankuesja



bazuar në e-mailin e datës 01.04.2022 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shprehje të interesit, e njëjta ka shprehur interesin të sistemohet në pozitën Drejtor i Departamentit të Diasporës, e për të cilën pozitë përveç ankueses kanë shprehur interes dhe tre (3) nëpunës të tjerë. Komisioni i Ristrukturimit ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të të gjithë të interesuarave dhe në bazë të formularit të vlerësimit ankuesja për nga vjetërsia në shërbimin civil ka marr 15 pikë, tek vlerësimet e rezultateve në punës është vlerësuar me 13 pikë, tek kualifikimet profesionale ka marr 20 pikë, ndërsa tek trajnimet ka marr 11 pikë nga kjo gjithsej 59 pikë, duke u vlerësuar me më së paku pikë nga të gjithë kandidatët e interesuara, rrjedhimisht Komisioni i Ristrukturimit për pozitën Drejtor i Departamentit të Diasporës ka rekomanduar kandidatin S.Ukshini pasi që i njëjti është vlerësuar me gjithsejtë 86 pikë. Në Raportin me numër protokoll 596 të datës 19.04.2022 Komisioni i Ristrukturimit ka bërë propozimin të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil pasi që e njëjta nuk plotëson kriteret për asnjë pozitë të lirë te mesme drejtuese në MPJD. Me tej Komisioni i Ristrukturimit me Raportin plotësues me numër protokoll 615 të datës 22.04.2022, ka propozuar që ankuesja të sistemohet në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ankuesja më datë 29.06.2022 kishte parashtruar ankesë me numër protokoll 3802/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.12/2022 të datës 10.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve, ndërsa Këshilli më Vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, më Raportin e Veçantë të Punës me numër protokoll 1620 të datës 01.11.2022, ka konstatuar se ankuesja nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme lidhur me pozitat e lira të kategorisë së mesme drejtuese, rrjedhimisht ka propozuar që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të Shërbimit Civil, duke rekomanduar transferimin në vendin e punës Udhëheqës i Autoritetit Rajonale të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datë 10.11.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.150/2022 të datës 11.01.2023 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Udhëheqës i Autoritetit Rajonale të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar kundër Vendimit me Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pretendon se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka marr parasysh të gjeturat sipas Vendimit A.nr.723/2022 të Këshillit dhe së vendimi i kontestuar me ankesë është nxjerr me shkelje të dispozitave ligjore për faktin që nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe juridike sepse ka plotësuar të gjitha kushtet për pozitën e Drejtorit të Departamentit të Diasporës. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohj Vendimin me Nr.150/2023 të datës 11.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Vendimin më numër protokoll 1620 të datës 01.11.2022 të Komisionit të Ristrukturimit, duke obliguar këtë të fundit që të rishqyrtoj



rastin dhe të rekomandoj transferimin e ankueses në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Diasporë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"1.Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës"* dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit kanë pësuar ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, Kolegji konstaton se si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës, është bërë riorganizimi i këtyre dy ministrive i materializuar më Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe si rrjedhojë e riorganizimit ka pas shuarje të pozitave të caktuar të punës siç ishte rasti i shuarjes pozitës së ankueses, krijim të pozitave të reja të punës si dhe ndryshime të kriterëve për pozita të caktuara.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka marr parasysh asnjë të gjetur sipas Vendimit A.nr.723/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të çështjes ka konstatuar së Komisioni i Ristrukturimit në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 ka rishqyrtuar rastin e ankueses, ka bërë vlerësim të pozitave të lira të kategorisë së mesme drejtuese me qëllim të sistemimit të ankueses mirëpo sipas Raportit të Veçantë të Punës me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022, ka vlerësuar së ankuesja nuk plotëson kualifikimet e veçanta për asnjërën nga pozitat e lira të kategorisë së mesme drejtuese në MPJD. Ndërsa, përkitazi me pretendimin ankimor së ankuesja ka plotësuar të gjitha kriteret për pozitën e Drejtorit të Departamenti të Diasporës, Kolegji nga shqyrtimi i dosjes personale të ankueses ka konstatuar së e njëjta ka plotësuar të gjitha kushtet për pozitën Drejtor i Departamentit për Diasporë, mirëpo, bazuar në procesin e vlerësimit sipas pikëzimit e njëjta ishte vlerësuar me vetëm gjithsej 59 pikë, duke u vlerësuar me më së paku pikë nga tre kandidatet e interesuar për këtë pozitë, kështu që në vlerësimin e Kolegji, Komisioni i ristrukturimit ka vetëtuar drejt gjendjen faktike dhe ka vepruar në pajtim me nenin 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet"*.

Me qëllim të vlerësimit sa më të drejtë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe kriteret lidhur me pozitat e kategorisë së mesme drejtuese që kanë qenë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës gjegjësisht për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje



Ligjore dhe Traktate tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: "Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare në Juridik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze., për pozitën Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose frënge në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose frënge dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose frënge, për pozitën Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë si kritere janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose frënge në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose frënge dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose frënge, për pozitën Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit si kritere të përcaktuar janë: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare në Juridik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze" për pozitën Drejtor i Departamentit për Organizatat Ndërkombëtare tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Shkenca Politike, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e ndonjë prej gjashtë(6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura, rrjedhimisht Kolegji bazuar në shqyrtimin e dosjes personale të ankueses ka gjetur së e njëjta sipas diplomës me nr.1125 të datës 14.07.2005, ka të përfunduar Fakultetin Juridik dhe së ka përvojë profesionale dhe udhëheqëse, mirëpo, lidhur me pozitat e lira të përshkruar si me lart, ankuesja nuk ka plotësuar kualifikimet e veçanta lidhur me njohjen e gjuhës angleze, gjegjësisht ankuesja lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja posedon certifikatat e lëshuar nga Shkolla e Gjuhëve të huaj " Zas-trade" lidhur me përfundimin e nivelit të gjuhës angleze Beginner, Elementary, Pre-Intermediate dhe Intermediate, pra ankuesja nuk posedon dëshmi lidhur me njohjen e gjuhës angleze të nivelit B1-C2.

Përkitazi me ligjshmërinë e vendimit për transferimin e ankuesit në institucion tjetër të shërbimit civil, përkatësisht në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Autoritetit Rajonale të Pellgjeve



Lumore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës, Kolegji ka analizuar kriteret e përcaktuara për këtë pozitë pune: *Diplomë universitare fakulteti ekonomik, juridik shkencat e natyrë, fakulteti teknik, së paku 7 vite përvojë punë duke përfshirë 4 vite përvojë punë në vende udhëheqëse*, dhe si rrjedhojë vlerëson se Vendimi me Nr.150/2023 i datës 11.01.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme është nxjerrë në pajtim me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse është plotësuar kriteri i transferimit në kategori të njëjtë si dhe kriteri i plotësimit të kushteve dhe kualifikime për pozitën përkatëse, kështu që bazuar edhe në konstatimet si më lartë Kolegji vlerëson së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankueses.

Përmbledhur si me lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.95/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërrkohet:

- Ankueses
- Drejtorit të DMZP-së;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së